

The book cover features a vibrant, painterly illustration. The top half shows a city skyline with tall skyscrapers under a bright, yellow and orange sky. A large, billowing cloud of purple and blue smoke or mist rises from the city, partially obscuring the buildings. The bottom half of the cover is a snowy landscape with several tall, thin, white tree trunks. In the foreground, a man with long, flowing blonde hair, wearing a blue shirt and a purple cape, is running towards the right. He is carrying a young girl with long blonde hair in his arms. The overall color palette is dominated by purples, blues, and yellows, creating a dramatic and fantastical atmosphere.

Çelestja, planeti im

Timothée de Fombelle

Letërsi e huaj për të rinj
Timothee de Fombelle
Çelestja, planeti im
DITURIA

Timothee de Fombelle

Çelestja, planeti im

Përktheu: Venera Domi



Illustruar nga Julie Ricossé

Shtëpia Botuese DITURIA

Titulli origjinal:
Timothée de Fombelle
Céleste, ma planète

Redaktore: Mariana Ymeri
Paraqitja grafike: Ulinda Selenica

Céleste, ma planète © Gallimard Jeunesse, 2009
Copyright © për botimin shqip, DITURIA, 2023



Ky projekt është realizuar me mbështetjen financiare të Komisionit Europian. Ky botim pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimet e mundshme të informacioneve që përmban teksti.

Cet ouvrage a bénéficié du soutien des
Programmes d'aide à la publication de l'Institut français

Shtëpia Botuese DITURIA
Rruga "Frederik Shiroka", Nr. 31, Tiranë
P.O. Box 1441
Tel.: + 355 4 2236 635; Cel.: + 355 692048503

E-mail: sekretaria@dituria.al
www.dituria.al

■ Shtëpia Botuese DITURIA

1



Herën e parë që më puthi, ishim varur me kablo njëqind e njëzet metra nga toka dhe na ishin qepur pas pesëmbëdhjetë njerëz të armatosur. Ndoshta kjo ishte edhe arsyeja pse, për një kohë të gjatë, sa herë që i afrohesha, më merreshin mendtë.

Sot po i shkruaj emrin në krye të kësaj fletoreje të vogël e të qullur, që më ka mbetur. Bën ftohtë. Zjarri nuk ngroh fare. Nuk e di se si nuk po ngrin edhe boja e stilolapsit. Kjo histori nuk është aq e gjatë, sa për të shkruar një roman. Por mjafton për të lënë një gjurmë, gjurmën kaltëroshe të asaj që ndryshoi jetën time dhe mund të kishte ndryshuar edhe botën.

Çelestja.

Kisha vendosur të mos bija më në dashuri.

E kisha marrë këtë vendim shumë herët, kur isha gjashtë apo shtatë vjeç. Në moshën kur dikush betohet të mos shkelë më në pishinë dhe të mos veshë më rroba banje, sepse instruktori i notit i ka ulëritur para të gjithëve: “Mos i përplas ashtu këmbët, dukesh si qofte!” Ka nga ata që vendosin të mos zhveshin as edhe një centimetër katror të lëkurës së tyre buzë pishinës, në atë moshë. Kurse unë e kisha vendosur zemrën nën një kambanë të rëndë, si kapaku i një pusete.

Më parë, nga zero deri në gjashtë vjeç e gjysmë, bija në dashuri me çdo vajzë që më dilte përpara e që kishte bishtaleca e këpucë me fjongo. Përfundonte gjithmonë keq. Sindroma e bukëthekëses. Në fillim ndieja gjithë lezet kur më

ngrohej zemra nga të dyja anët, pastaj zemra kërcente përpjetë dhe mandej binte e plasej në dysheme.

Kështu që vendosa t'i jepja fund.

Ndodhi një mëngjes, te dyqani i bukës në katin e shtatëdhjetë e shtatë. Po prisja të blija një kruasan. Duke folur paksa mbi supin tim, shitësja tha:

-Jeni bashkë?

U ktheva. Ishte Charlota, një vajzë pak më e madhe se unë. Ia ngula sytë dhe u zbeha. Më pëlqente shumë ajo vajzë, me tela në dhëmbë. Dhe më mjaftonte ta shihja e gishtat e këmbëve më mblidheshin në këpucë, ndërsa goja më thahej si shkretëtira e Kalaharit.

-Jeni bashkë?- përsëriti shitësja.

Në të vërtetë, donte të dinte nëse bashkë me kruasanin tim do të paguaja edhe bonbonet e Sharlotës.

-Jeni bashkë?

Pyetja për mua kishte tjetër kuptim, që më rrëqethte mishin.

U përpoqa të thosha “jo”, po zëri m'u zu në grykë. Tingulli që doli i ngjante më shumë rënkimit çjerrës të derrkucëve të Indisë. Bukëthekësja kishte filluar të më ndizte kraharorin. Charlota buzëqeshi, duke zbuluar gjithë pllakëzat që i vishnin

dhëmbët.

-Mos të të gënjejë mendja,- më tha.



Vuri gjerdanin e bonboneve në qafë dhe hodhi një monedhë mbi banak.
Në atë çast, vendosa t'i jepja fund.
U betova. Nuk do të bija më në dashuri.

Të nesërmen, zura të vizatoja harta. Vizatoja hartat e botës nëpër mure,
luaja edhe në piano.

Kaq.

Gjatë tetë viteve që pasuan, vetëm me këto u mora, përveç shkollës e
bisedave me Brisin.


Brisi...

Ah sa do të doja të kisha më shumë vend për të folur për Brisin. Ai meriton
tri faqe të mbushura plot, me kujtime që do të zinin edhe anët e fletëve, por i
ftohti është therës, fletorja tepër e vogël dhe duhet vazhduar...

Brisi banonte në kullat me tulla. Babai i tij lante fasadat prej xhami të
pallateve, në lagjen time.

Unë banoja në kullën *!mmensity*, dy blloqe larg shkollës. Për të mbërritur në
shtëpinë time, mjafton të kalosh tre urat e këmbësorëve në lartësinë e katit të
njëqindtë, pastaj të ngjitesh edhe nja dyzet kate të tjera.

Shtëpia ime është e madhe. Tepër e madhe. Kur isha më i vogël, humbja. Në korridor mund të parkoje një tren të tërë. Kishte shtatë dhoma mysafirësh, por as edhe një mysafir.



Pas shkolle, Brisi vinte në shtëpië time, në kullën *!mmencity*. Rrinte me mua, teksa priste të atin, që punonte deri vonë në mbrëmje.

- Brisi!

Gjithmonë e njëjta skenë, rreth mesnate.

- Brisi!

Ishte babai i tij, hipur mbi një platformë, që e thërriste dhe trokiste te xhami. Hapnim dritaren dhe, sakaq, uturima e qytetit e mbyste dhomën. Vinte era e larësit të xhamave, një erë si llastik tullumbaceje. Brisi hipte në platformë me larësin e xhamave.

- Paçim, nesër...

Të dy tok, babë e bir zbrisnin përgjatë murit të xhamtë. Mbërrinin në shtëpinë e tyre, natën vonë.

Më pëlqente shumë babai i Brisit, zanati i tij prej akrobati, kacavjerur nëpër kulla. Edhe Brisin e doja shumë.

Tani e di që për gjithçka u detyrohem atyre.

Kurse Brisi donte shumë mamanë time. Ma thoshte për të më ngushëlluar. Është më e lehtë t'i duash njerëzit, kur nuk i ke parë kurrë.

Sepse mamanë time nuk e shihje kurrë në shtëpi. Asnjëherë. Ajo punonte te *!ndustry*. Nisur nga modeli i flokëve dhe veshja, duhej të ishte një nga shefat e mëdhenj. Punonte jashtë mase. Dhe udhëtonte pa reshtur.

Unë e shihja një herë në muaj, në sallën e pritjes së zyrës së saj.

Mamaja ma mbushte frigoriferin çdo të hënë, duke porositur online. Donte që të mos më mungonte gjë. Shpërndarësi i sillte në orën dhjetë të mbrëmjes. Sillte sasi astronomike. Tetë arka çdo të hënë. Gjatë javës, unë haja vetëm tri vezë, ca makarona dhe ca brokoli. Jo më shumë. Pastaj gjithçka niste nga e para. Tetë arka të tjera.

Mbushja e frigoriferit online ishte një makth i vërtetë. Nuk e përballoja dot.


Një herë në javë tringëllinte telefoni.

- Si je zemër? Të duhet ndonjë gjë?

Nuk ishte mamaja. Ishte Grunda, sekretarja e saj.

Mamaja ime nuk kishte kohë.

Për fat, kisha Brisin. Merrej ai me frigoriferin, teksa unë vizatoja hartat e mia. Ndonjëherë, pas gjashtëmbëdhjetë djathërave të bardhë dhe një kileje fëstëkë, dukej sikur ia kishte dalë ta zbrazte. Por i mbeteshin ende njëzet e katër tuba me lëng marshmallou, të cilat e joshnin me sytë e tyre rozë.



Brisi hidhte në plehra një metër kub ambalazhe bosh çdo darkë, përpara se të ikte. Ende më jehon në vesh zhurma e plastikës që copëtohej në plehragrirëse.

Më kujtohet edhe abonimi në “Je console”, pesë lojëra që i paguante mamaja dhe që më mbërrinin drejt e në kompjuter çdo të mërkurë. Përsëri Brisi më nxirrte nga situata: luante gjashtë apo shtatë orë rresht, duke ngrënë patatina, ndërsa unë, në dhomën time, i bija pianos.

Mjaftonte emri i asaj loje që të dëshpërohesh: “Je console”, më tingëllonte si “Konservoj”.

Nuk mora ndonjëherë mësimë pianoje. Luaja çfarë kisha në kokë dhe në gishta. Gjithmonë melodi të trishtuara.

Po të kisha dëgjuar përnjëmend çfarë më luanin gishtat, mbase do të kisha dyshuar nëse jetoja vërtet.

Por, ama, nuk u mërzita kurrë. Kurrë. Tani që e mendoj, kjo është e vetmja dhuratë që mamaja më ka bërë, duke më lënë të rritesha vetë: nuk dija ç'ishte mërzia.

I kisha hequr kapakun pianos, për t'i parë mekanizmat brenda, litarët dhe çekiçët. Ndonjëherë më zinte gjumi mbi tastierën që buzëqeshte, duke zbuluar gjithë dhëmbët e saj.

Deri tani kam nxirë disa faqe, por akoma nuk kam nisur të tregoj atë që ka rëndësi. Duhet të nxitoj. Bën ftohtë. Jashtë po ngrihet era.

Kisha vendosur të mos bija më kurrë në dashuri.

Por ditën kur mbusha katërmëdhjetë vjeç, më doli përpara ajo.

Nuk dihej nga vinte.

Jetonte me prindërit në majën e kullës 330.

Treqind e tridhjeta ishte kulla e parkimit të lagjes së xhamtë. Aty makinat parkoheshin vertikalisht, si librat në bibliotekë.

E bënin me ca vinça specialë.

Sot, kur e mendoj, më duket një ide fare pa mend. Treqind e tridhjetë kate me makina. Njëlloj sikur të varësh pjatat në varëset e rrobave në dollap. Por më kujtohet që, asokohe, kjo më dukej normale e madje edhe mjaft e zgjuar.

Ndoshta kjo më shqetëson më shumë. Mendimi që kjo botë më dukej normale e madje edhe mjaft e zgjuar.


Çelestja.

M'u shfaq një ditë në ashensor. Ngjitëm njëqind e pesëmbëdhjetë kate në heshtje. Gjëja më e jashtëzakonshme ishte se askush nuk e ndërpreu këtë fluturim jashtë kohe, të dy bashkë në ashensor.

Kishte aromën e tokës së ngrohtë, Çelestja.

M'u duk sikur do të ngjiteshim pa fund, do të arrinim retë e do të ceknim Hënën në anën e errët. Gjëja më e jashtëzakonshme ishte se ajo ndaloi në katin e njëqindtë e pesëmbëdhjetë, njëloj si unë. Dhe hyri në shkollë, ashtu si unë.

Më humbi nga sytë nëpër korridore.



Por tamam para pushimit të madh, në klasë hyri drejtori.

- Po ju njoh me Çelesten. Mund ta mirëprisni.

Ishte pikërisht ajo. Disi e fshehur, pas tij.

Brisi mungonte. Një ditë më parë, kishte ngrënë tek unë dy kuti me kokoshka. Vendi i tij qe bosh. Ishte i sëmurë.

Ajo erdhi dhe u ul përbri meje.

Kur isha fare i vogël, një herë pata shkuar me babain në cirk, në katet e nëndheshme të *Intencity*, qendrës tregtare. Zbutësi e uli një panterë të zezë, mu te ndenjësja afër meje. Përjetova të njëjtën ndjesi, kur Çelestja u ul te banka e vogël në krah tim.

“Po ju njoh me Çelesten. Mund ta mirëprisni.”

Mua m’u dëgjua si “mund ta prisni” dhe nuk po arrija ta kuptoja se si drejtori e tha një gjë të tillë.

E kërkova Çelesten me vështrim në tarracën e shkollës. Por ajo kishte ndenjur në klasë, për të plotësuar një formular. Ndërsa unë, i mbështetur te parvazi i tarracës prej xhami, përsërisja me vete: “Mos bjer, mos bjer, mos bjer”.

Kisha frikë se do të bija në dashuri.

Kur erdhi ora e drekës, ajo u largua.

Dhe nuk vuri më këmbë në shkollë.



2



Kaluan ca javë.

Shumë kohë më parë mbillja fasule në pambuk të lagur. Nuk ka më keq sesa ditët e para. Nuk ndodh gjë prej gjëje. Humbet kohën kot, duke parë fasulet. Madje as pambuku nuk thahet dhe aq shpejt. Kurse ty të vjen ta ujisësh nga pak.

- Mos e ujit shumë. Do t'i kalbësh!

Disa gjëra, në jetë, zgjatin shumë.

Në ditët e para pa Çelesten kisha të njëjtin padurim. Kisha jetuar katërmbëdhjetë vjet pa ditur gjë se ajo ekzistonte. Kisha kaluar vetëm një gjysmë dite me të. Por tani edhe një minutë pa të, ishte më keq se një ditë i përkulur përpara fasuleve të mbjella.

Brisi u kthye te vendi i vet të nesërmen dhe po i dukësja i çuditshëm. Më shkruante pusulla të shkurtra: “Se si më dukesh...”

Kishte të drejtë. Se si ndihesha.

Po, sepse kisha kërcyer përpjetë nga bukëthekësja, si edhe më parë, por këtë herë nuk pranoja të plasesha në tokë. Këtë herë kisha vendosur të qëndroja pezull në ajër.

Përfytyroni një fetë buke që, në çastin kur duhet të bjerë poshtë, befas ngrihet, fillon të rrahë krahët, ngjitet lart, cik mbulesën plastike të tavolinës dhe niset fluturimthi drejt dritares.

Përfytyroni një fetë buke që rebelohet.

Pasdite po vizatoja hartat e mia.

Kisha një a dy muaj që i isha kushtuar Amerikës së Jugut. Kisha marrë një duzinë atlasesh dhe po grumbulloja gjithë të dhënat në një hartë të vetme, vizatuar në murin e bardhë të dhomës sime. Vitin e shkuar, kisha përfunduar Azinë dhe tri të katërtat e Paqësorit, në krah të derës së banjës. Oqeani Indian derdhej pakëz mbi parket.

Amerika e Jugut.

Përpiqesha të përqendrohesha. Në atë cep të botës, mjafton një sekondë shpërqendrim për të rrëshqitur majën e Kilit mbi Peru, apo për të harruar në majat e larta një qytet me një milion banorë.



Por Çelestja më vërtitej në kokë si fugë. Hera-herës ndalja për një çerek ore, krejt i shtangur, duke rjetuar skenën në ashensor. Nuk isha në gjendje të dilja

nga kjo tultatje, i magjepsur, i paralizuar, me penelin pezull mbi Tokën e Zjarrtë.

- Më dëgjon?

- Eëë?

Ishte Brisi.

- Të thashë që e mbarova kanatin e ngrirjes.

- As që më bëhet vonë fare për kanatin tënd të ngrirjes. Trashalut.

Ja si iu përgjigja Brisit.


Ai qëndronte aty, përpara meje, krenar, me hundën e zbardhur nga sheqeri pluhur dhe fytyrën që i shkëlqente. Të mbaroje kanatin e ngrirjes të premtën në darkë, ishte rekord. Ia kishte dalë të sfidonte veten. Dhe unë, për herë të parë, në vend që ta falënderoja, po i përgjigjesha duke e sharë.

Pashë se si iu turbullua vështrimi. Pastaj Brisi më ktheu shpinën dhe doli, duke përplasur derën.

Lëshova penelin dhe mbështeta ballin pas murit. E kuqja e Kubës duhej të më ishte ngjitur nëpër flokë. Dola nga dhoma dhe renda në korridor, duke thirrur Brisin. Doja t'i kërkoja të falur.

- Bris!

Kur u hyra në dhomën e ndenjjes, pashë platformën e larësit të xhamave përpara dritares. Brisi ishte me të atin.



- Bris, më dëgjo!

Platforma zuri të zbriste. U zhdukën.

Të nesërmen, dola të kërkoja Çelesten.

330-a është në anën tjetër të lagjes prej xhami. Duhet të kalosh një varg kullash, për të arritur aty. Qarkullimi jashtë u rezervohet vetëm makinave. Kjo siguron rrugë të shpejta, tunele dhe korridore lidhëse që ngatërrohen me njëra-tjetrën si në një pjatë me makarona. Kështu që zgjedha kalimet e mbuluara dhe galeritë tregtare.

Ishte e shtunë. Kushedi sa njerëz kishte, çmenduri, por nuk më kujtohet thujse asgjë. Ecja mes turmës në drejtim të kullës 330, me sytë poshtë. Deri edhe dyshemetë e këtyre galerive janë mbuluar me ekrane, që shfaqin reklama. M'u lodhën sytë. Po përpiqesha të sillja ndërmend fytyrën e Çelestes. Nuk i dija as mbiemrin. Nuk ia kisha dëgjuar kurrë zërin t'i kumbonte.

I hipa ashensorit të fundit në kullën *Intencity*. Po zbriste ngadalë, për t'u lënë kohë njerëzve të bënin blerje. Është një ashensor prej xhami, ku gjendet një ushqimore, një bar dhe një dyqan këpucësh.



Intencity është qendra më e madhe tregtare në qytet. Kur je në ashensorin prej xhami, shikon, nga ana tjetër, kullën 330 mbështjellë nga reja e saj prej tymi. Ngrita sytë nga maja e kullës-parkim.

Ndoshta Çelestja ishte aty lart, mes asaj tymnaje gri.

Pastaj ashensori zbriti në katet e nëndheshme. Nja njëzet kate nën zero. Shumë njerëz zbritën bashkë me mua, kur arritëm në fund fare. Shkonin të merrnin makinat. Ndoqa lumin e këmbësorëve që mbanin nëpër duar çanta plastike. E dija se brenda atyre qeseve kishte qese të tjera, me qese të tjera më të vogla, mbushur me qese akoma edhe më të vogla.

Njerëzit i adhurojnë qeset.

Unë kisha vetëm dy xhepat e pantallonave. Me duart mbledhur grusht brenda tyre.

- Numri i makinës?

Djali i parkimit po më vështronte.

- Nuk kam numër. Po kërktoj mamin, më humbi nga sytë atje lart. Por do të kalojë patjetër këtej, për të marrë makinën.

- Nuk ke celular që ta marrësh në telefon?

Po më shihte si të isha humbamenoja më i madh.

- Jo.

Kësaj here nuk po gënjeja. Nuk kam mbajtur kurrë celular. Dhe, po të isha qen, nuk do të kisha dashur kurrsesi të më vinin litar.

- Ulu aty.

U binda. Ishte një stol mjaft i lartë, i parehatshëm, shumë pranë një dere metalike. Prita pak, duke vëzhguar.

Ai tipi u kërkonte klientëve numrin, e shtypte në një tastierë dhe, nga një prej treqind e tridhjetë katet, zbriste makinën. Drejtuesit shkonin pastaj për ta marrë pak më tutje, duke kaluar përmes një galerie dyqanesh të tjera, ku mund të pasuronin koleksionin e tyre të qeseve plastike.

Kaluan njëzet minuta. Vura re se, në dy raste, klientët i kishin humbur numrat dhe se djali i çonte te një kompjuter i vogël mënjanë.

Gjatë atyre pak sekondave që u merrte shenjat e gishtërinjve, djali më kthente shpinën. Pesë sekonda më duheshin për të vepruar.

Kështu, herën e tretë, zbrita nga stoli dhe shtyva derën metalike. Nuk ishte e mbyllur me çelës. Hyra nxitimthi në korridor. Dyert e një ashensori fare të vockël ishin të hapura. Shtyva 330 në tastierë dhe kabina nisi të ngjitej.

Ashensori lëvizte me zhurmë, ama shpejt. Po pyesja veten nëse Çelestja e kishte përdorur ndonjëherë këtë rrugë vertikale.

Nxora nga xhepi çfarë më kishte sjellë deri aty.

Çelestja e kishte lënë formularin me të dhënat mbledhur shuk te dollapi i saj në shkollë. Vetëm dy rreshta kishte plotësuar. Emrin, Çeleste, dhe adresën, ku jepet gjithmonë emri i kullës dhe kati.

Çelestja kishte shkruar: “330/330”.

Edhe pse duheshin vetëm pak sekonda për të ngjitur çdo kat, m’u desh një çerek ore e mirë për të arritur në majë.

Makina të ngjeshura në një kilometër lartësi... Kur e kujtoj, më mblidhet një lëmsh në stomak. Dera e ashensorit u hap dhe një dallgë tymi më mbështolli të tërin. Nxehtësia e motorëve të mijëra makinave të rreshtuara në qindra kate, ngrihej lart si një kolonë kaltëroshe.

Me disa hapa, arrita në tarracë. Gojën e kisha mbuluar me mëngë, për të filtruar gazrat e shkarkimit. Kujtoja se ajri jashtë ishte më i pastër, por, me të dalë në tarracë, u gjenda nën një shtresë reje që qëndronte pezull në majën e kullës, ku përqendrohej gjithë ndotja. Disa ventilatorë gjigantë të instaluar atje nuk arrinin ta vinin ajrin në lëvizje.

- Çfarë kërkon këtu?

Përballë meje, në mjegull, qëndronte një burrë me kominoshe jeshile. Kishte vënë kapuç.

- Po kërkoj Çelesten.

- Përse e do?

- Dua ta takoj.

- Përse?

Pyetje e çuditshme. Njëlloj sikur të më pyeste përse doja të jetoja. E si t’i përgjigjesha?

- Çelestja ishte në shkollën time.

Ai m’u afrua. Ishte shumë i madh. Te rripi i mesit mbante lidhur një kuti veglash. Nën sqetull kishte dy shishe ujë dhe bukë. Dukej sikur po kthehej për në shtëpi... Po kush vallë mund të jetonte në një vend të tillë?

- Nuk ka ndonjë Çeleste këtu.

- Dua ta takoj. Pastaj do të iki.

Tani ishte shumë pranë meje. Po më shikonte dhe ngjante më pak i shqetësuar. Me sa duket, nuk kisha pamje të rrezikshme, jo shumë i gjatë, jo shumë i fuqishëm, duke u kollitur te mënga. Me atë theksin e tij të çuditshëm, më tha sërish:

- Nuk ka ndonjë Çeleste këtu. Nuk ekziston.

Toni i tij ishte i prerë. Normalisht, duhej të kisha hequr dorë. Së pari, nuk kisha asnjë të drejtë të isha aty. Pastaj, ai qe dy kokë e një kapuç më i gjatë sesa unë. Për të mos folur pastaj për peshën. Normalisht, duhej të kisha vënë majat nga thembrat dhe të isha nisur drejt ashensorit, drejt jetës sime të vogël, pianos dhe hartave të mia.

Normalisht.

Por asgjë nuk ishte më normale. Një thërrime marrëzie po hidhte rrënjë, në këtë tarracë të zezë. Një bar i marrë, që do të mbinte e do të përhapej, do të rritej e do të shtrinte degët brenda meje. E doja Çelesten.

Madje as nuk u mundova gjatë për të shqiptuar fjalinë më të çmendur, që mund të thosha në atë çast.

- Duhet t'i thoni se është një hajdute.

Këto fjalë qenë krejt pa lidhje. Nuk kishin asnjë kuptim, por, falë tyre, ndjeva të afrohej çasti të cilit i trembesha, por edhe e dëshiroja më shumë. Një dorë e stërmadhe më kapi për fyti dhe më ngriti lart. Burri po më mbante pezull, në lartësinë e fytyrës së vet.


- Çfarë the?

- Çelestja është hajdute.

Qepallat iu tendosën, kurse dora e tij ma shtrëngoi edhe më fort grykën.

- Djalosh, çfarë the?

- Thashë që Çelestja është hajdute, por kjo nuk ka rëndësi, meqë ajo nuk ekziston...



Nuk kam vend këtu për të treguar fije e për pe rreth faktit se, zakonisht, nuk kam shpirt heroik. Le të themi vetëm se nuk kam qenë kurrë tip që provokoj më të mëdhenjtë, madje as më të vegjlit. Nuk guxoj të prekja gjë tjetër, veç tetëdhjetë e tetë tasteve në pianon time. Kisha hequr dorë, që në lindje, nga përpjekja për të ndryshuar botën. Atë botë që, në muret e dhomës sime, e vizatoja ashtu siç ishte, pa i ndryshuar kurrëgjë...

- Çelestja nuk vjedh asgjë.

Buzëqesha. Ai e tha atë fjali duke shtrënguar dhëmbët, gati të më mbyste, por mua më mbushi me gëzim. Çelestja ekzistonte. Ai e njihte.

- Dua ta shoh.

Burri duhet ta ketë ndier emocionin në zërin tim. Më uli. Zbërtheva jakën, duke u përpjekur të merrja frymë. Ai më vështroi gjatë. Pastaj u largua dhe unë e ndoqa.

Nuk e ndieja më pluhurin e zi që rëndonte ajrin. Po ndiqja atë burrë mes turbinave. Po ecte drejt buzës së tarracës. E dinte që isha pas tij. Hapi një kapanxhë. Sakaq ia behu drita. Shqiptoi disa fjalë në një gjuhë të panjohur. Zbrita pas tij shkallaret e një shkalle të fiksuar në beton.

Dy sy shkëlqenin në gjysmerrësirë. Ishte një grua. Unë përsërita:

- Kërkoj Çelesten.

Gruaja më priu për te një dhomë tjetër fare e vogël, edhe më pak e ndriçuar.

Shtrirë përtokë, duke u dridhur, me fytyrën e mbuluar nga njolla të vogla, me duart e këmbët e fashuara, Çelestja po më vështronte.